



Në bazë të nenit 34, 35 dhe 46 të Ligjit mbi planifikimin dhe rregullimin e hapsirës ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 2/89), nenit 3 të Rregullorës mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000 dhe nenit 40 alinea 3 pika 2 të Statutit të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me 27.02.2003, mori

**V E N D I M**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR MIRATIMIN E**  
**PLANIT DETAL URBANISTIK TË KOMPLEKSIT "QENDRA UNIVERZITARE"**  
**NË PRISHTINË**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për miratimin e Planit Detal Urbanistik të kompleksit "Qendra Univerzitare" në Prishtinë, i shpallur në ("Gazetën Zyrtare të Kosovës" nr. 54/75).

**Neni 2**

Pjesës së ngastrës kadastrale nr. 7090/1,2 Komuna Kadastrale e Prishtinës, i ndryshohet destinimi, nga ai i paraparë si hapsirë për ndërtimin e Objektivit të Institutit të Kimisë, me destinim për ndërtimin e Objektivit të Institutit të Historisë

Pjesë përbërëse e vendimit mbi ndryshimin dhe plotësimin e këtij plani është pjesa tekstuale dhe ajo grafike.

**Neni 3**

Bartës i detyrës për ndryshimin e këtij Vendimi nga aspekti i ndryshimit të pjesës tekstuale dhe grafike të elaboratit të Planit Detal Urbanistik nga neni 1. i këtij Vendimi është Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës, ndërsa Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, do të kryejë veprime procedurale nga përgjegjësia e tij.

**Neni 4**

Bazë për përgaditjen e dokumentacionit teknik për realizimin e projektit për ndërtimin e objektit në fjalë janë kushtet urbanistike-teknike si pjesë përbërëse e këtij plani.

**Neni 5**

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Bordi i Drejtorëve të Komunës së Prishtinës.

**Neni 6**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.NR. 350-267 DT. 04.03.2003**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**

ARSYETIM  
I PROPOZIM VENDIMIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT  
PËR MIRATIMIN E PLANIT DETAL URBANISTIK TË KOMPLEKSIT "QENDRA  
UNIVERZITARE" NË PRISHTINË

Instituti i Historisë së Kosovës i është drejtuar këtij Drejtorati me kërkesë për shqyrtimin e programit për ndërtimin e objektit të këtij Instituti të Historisë si dhe caktimin e lokacionit të përcaktuar nga ky institucion. Për ndërtimin e objektit të këtij instituti është siguruar edhe pëlqimi i Rektoratit të Univerzitetit të Prishtinës që i njëjti të ndërtohet në kuadër të kompleksit të Qendrës Univerzitare.

Ky Drejtorat duke shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe duke u bazuar në programin preliminar si dhe pëlqimit nga ana e Rektoratit e ka analizuar propozimin në fjalë mirëpo, për caktimin e këtij lokacioni është e domosdoshme që paraprakisht të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i planit detal urbanistik të kompleksit Qendra Univerzitare në Prishtinë pasi që, lokacioni për të cilin ky institut është përcaktuar dhe ka siguruar pëlqimin nga Rektorati, në planin detal urbanistik ekzistues ka qenë e paraparë si hapsirë për ndërtimin e Institutit të Kimisë.

Me këtë propozim vendim është ndryshuar plani detal i kësaj qendre i miratuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës të Prishtinës i shpallur në ("Gazetën zyrtare të Kosovës" nr. 54/75) përkatësisht, është bërë vetëm ndryshimi në aspektin e destinimit me përmbajtje të parapara me plan ekzistues.

Është e rëndësishme të theksohet se plani detal i kësaj qendre shumë herë ka psuar ndryshime dhe plotësime gjë që Drejtorati i Planifikimit, urbanizmit dhe Ndërtimtarisë në Programin e vetë të punës për vitin 2003 pos tjerash si detyrë prioritare ka planifikuar ndryshimin dhe plotësimin e planit detal të këtij kompleksi me përmbajtje dhe destinime tjera në tërësi sipas programeve dhe propozimeve të vetë Rektoratit të Univerzitetit të Prishtinës me ç`rast vend meritor do të ketë edhe destinimi për ndërtimin e objektit të Institutit të Kimisë në Kudër të kësaj Qendre.